



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në mbështetje të nenit 3, par1, pika “b” të Rregullores mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr.2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe të nenit 19, par 1, pika “b” të Statutit dhe Rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 23.11.2006 merr

V E N D I M
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT TË
BANIMIT PËR RASTET SOCIALE NË FUSHËN E PAJTIMIT

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit për rastet sociale në Fushën e Pajtitimit në Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr 832 dhe 834, Zona kadastrale Prishtinë, e evidencuar në fletën poseduese nr.224, në sipërfaqe prej 4 19 18 m².

Neni 3

Objekti i caktuar në këtë lokacion, sipas nenit 1 të këtij Vendimi, do të inkorporohet në planin e ardhshëm rregullues të hapësirës më të gjerë.

Neni 4

Ky Vendim paraqet bazë për dhënien e pëlqimit në lokacion, lëshimin e lejes urbanistike dhe lejimin e ndërtimit të objektit investiv, për të cilin është caktuar lokacioni sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës. Drejtorati i Planifikimit, Urbanizimit dhe i Ndërtimtarisë dhe Drejtorati i Kadastrit dhe i Gjeodezisë të Komunës së Prishtinës, do të kryejë veprime nga përgjegjësitë e tyre të caktuara për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e miratimit të tij nga Kuvendi i Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01.Nr.353-545, më 23.11.2006

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri